



Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2014
- Statusi Ligjor: Organizatë jofitimprurëse
- Selia Qendrore: Njesia Administrative 5, Rr. Sulejman Delvina, Nd.1, H 21, Ap.5 1019, Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: www.qendramedia.com
- Email kryesor i organizatës: mediaqendra@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: 00355692061304

2. Misioni

Krijimi i urave lidhëse të komunikimit dhe bashkëpunimit mes medias, publikut dhe shoqërisë civile që ndajnë të njëjtat vlera e qëllime me ne: Të fuqizojmë komunitetet për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetesës

3. Vizioni (Opsionale)

Të ndërtojmë një shoqëri të informuar, të përfshirë dhe të fuqizuar, ku media, qytetarët dhe shoqëria civile bashkëpunojnë në mënyrë aktive për të nxitur ndryshime pozitive dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës në komunitete.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- **Media dhe komunikim shoqëror.** Planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi i fushatave mediatike për ndërgjegjësim publik mbi çështje me rëndësi shoqërore.
- **Të drejtat e njeriut dhe çështje sociale.** Nxitja e debatit publik, edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështje si barazia, drejtësia sociale, dhe përfshirja.
- **Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm.** Promovimi i fushatave dhe iniciativave për mbrojtjen e mjedisit dhe edukimin mjedisor në nivel lokal dhe kombëtar.



Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore

- **Rinia dhe pjesëmarrja qytetare.** Fuqizimi i të rinjve përmes trajnimeve, përfshirjes në vendimmarrje dhe nxitjes së aktivizmit për një shoqëri më të hapur dhe demokratike.
- **Studim, trajnim dhe edukim.** Organizimi i studimeve, trajnimeve profesionale, leksioneve dhe kurseve në fushën sociale dhe të komunikimit.
- **Produksion mediatik.** Përgatitja dhe publikimi i materialeve ndërgjegjëse me karakter edukues, sociologjik dhe informues.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- **Projekti 1: “Countering Violent Extremism” (2024–2025)**

Ky projekt synon të forcojë kapacitetet e aktorëve kyç në parandalimin dhe kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm (P/CVE), si dhe në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të rikthyer nga zonat e konfliktit. Aktivitetet përfshijnë zhvillimin e fushatave komunikimi, krijimin e kundër-narrativave, trajnime për liderë komunitetesh fetare dhe prodhimin e materialeve audio-vizive ndërgjegjëse. Përfitues janë punonjësit e linjave të para, komunitetet lokale dhe institucionet që punojnë me persona në rrezik.

- **Projekti 2: “Fact vs Fiction – Edukimi i të rinjve mbi të vërtetat e migrimit” (2024–2025)**

Ky projekt, në bashkëpunim me British Council, synon të luftojë dezinformimin dhe keqinformimin që ndikon në vendimmarrjen e të rinjve në lidhje me migrimin e parregullt. Nëpërmjet trajnimeve, fushatave mediatike, materialeve edukative dhe përfshirjes së vetë të rinjve në krijimin e përmbajtjeve, projekti ndërgjegjëson grupmoshën 13–18 vjeç në zonat veriore të Shqipërisë mbi rreziqet e migrimit të jashtëligjshëm dhe promovon alternativa lokale.

- **Projekti 3: “Berlin Talks” (2023)**

Ky projekt kishte për qëllim ta sillte Agjendën e Berlinit më pranë publikut shqiptar përmes një serie emisionesh televizive të transmetuara në Euroneës Albania. Çdo episod trajtonte një temë kyçe – si agjenda e gjelbër, siguria rajonale, digjitalizimi, migracioni dhe zgjerimi i BE-së – në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për qytetarët. Përfitues ishin qytetarët, të rinjtë dhe audienca e gjerë online, të cilëve iu dha mundësia të kuptojnë më mirë proceset e bashkëpunimit rajonal dhe integritetit evropian.

6. Shtrirja Gjeografike



Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore

Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore (QMCSH) operon kryesisht në Shqipëri, me projekte të zbatuara në disa qytete dhe rajone, si më poshtë:

Vendet dhe rajonet ku operon organizata:

- Tiranë – qendra e organizatës dhe vendi ku zhvillohen shumica e trajnimeve, aktiviteteve mediatike dhe fushatave ndërgjegjësuere kombëtare.
- Shkodër dhe Kukës – aktivitete mbi dezinformimin dhe edukimin mediatik në lidhje me migracionin e jashtëligjshëm.
- Lezhë dhe Dibër – përfshirje në projekte me fokus në komunitetet vulnerabël dhe përhapjen e informacionit të verifikuar për të rinjtë.
- Durrës dhe Vlorë – përfshirje në nisma rajonale dhe bashkëpunime me aktorë lokalë në fushën e integritetit dhe zhvillimit komunitar.

Organizata është gjithashtu aktive në nivel kombëtar përmes fushatave mediatike, prodhimeve audio-vizive dhe partneriteteve me institucione qendrore dhe organizata ndërkombëtare.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Erida Shani

Bordi i Drejtuesve: Adnan Duka, Ornella Hado, Enida Sula, Shpend Doçi

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore (QMCSH) ka bashkëpunuar ndër vite me një sërë partnerësh dhe donatorësh kombëtarë e ndërkombëtarë, si: Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Rinisë, UN Women, UNDP, UNICEF, OSBE, Eorl Vision Albania, Organizata ka krijuar gjithashtu partneritete të qëndrueshme me media lokale dhe kombëtare, organizata të shoqërisë civile dhe rrjete rajonale të gazetarisë hulumtuese.

9. Ndikimi (Opsionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- [Numri] i njerëzve të përfshirë në x aktivitete
- [Numri] i pemëve të mbjella
- [Numri] i politikave të influencuara
- Etj.



Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Çdo zhvillim i fundit, çmime ose shfaqje në media për organizatën.

-